2862/5
29.10.26

OSSH OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES OSHEE GROUP

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A.
DEPARTAMENTI I MATJES DHE MBËSHTETJES SË TREGUT

Nr. 1112/1 prot. Tiranë, më 29.10.2026

Lënda: Përcjellje e Komenteve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a. mbi "Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike".

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
KRYETAR
Z. PETRIT AHMETI
Adresa: Irfan Tomini, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë

Të nderuar,

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a., me anë kësaj shkrese, paraqet komentet e tij mbi mbi "Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike". Në këtë kuadër propozojmë ndryshimet që i konsiderojmë të nevojshme në kontratën që do të miratojë Enti Rregullator i Energjisë, si vijon;

- Neni 14, pika 2, të riformulohet si më poshtë;

"14.2 Për furnizimin me energji elektrike, pa cenuar përgjegjësinë e OSSH-së për kryerjen e leximit të matësit, Klienti mund të kryejë vetëleximin e matësit për një periudhë 30-ditore dhe ia komunikon operatorit të sistemit të shpërndarjes, brenda afatit dhe sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, të dhënat e leximit për qëllime të përcaktimit të konsumit dhe faturimit të energjisë elektrike. Komunikimi i leximit duhet të shoqërohet me fotografi të aparatit matës, sipas procedurave të përcaktuara nga operatori. Të dhënat e vetëleximit i nënshtrohen verifikimit dhe trajtimit sipas rregullave në fuqi për matjen, faturimin dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe furnizuesit. Vetëleximi trajtohet si lexim real për qëllime faturimi. Nëse vërtetohet nga OSSH-ja mospërputhje, brenda një periudhe jo më të gjatë se 6 muaj, OSSH ka të drejtë të korigjojë leximin dhe Furnizuesi të lëshojë faturën sistemuese."

OSSH
OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES
OSHEE GROUP

- Neni 20, pika 5, të riformulohet si më poshtë;

"20.5 Klienti është përgjegjës për ruajtjen (mbrojtjen) e sistemit matës të energjisë elektrike, të vendosur nga OSSH brenda kufijve të pronës së Klientit"

- Aneksi 2, pika 7, të riformulohet si më poshtë;

"Konsumi i energjisë elektrike matet nga sistemi matës. OSSH-ja kryen leximin periodik të matësit. Klienti mund të kryejë vetëleximin dhe ia komunikon operatorit të sistemit të shpërndarjes, brenda afatit dhe sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Vetëleximi mund të përdoret për faturim si lexim real, nëse verifikohet nga OSSH-ja brenda periudhës së përcaktuar në Kontratë. Kur matësi nuk funksionon ose të dhënat nuk janë të disponueshme, faturimi kryhet sipas vlerave të referencës dhe rregullave të miratuara nga ERE.."

Me konsideratë,

ADMINISTRATORI I OSSH SH.A

Blendian DALIPI

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SHA
OSHEE GROUP SHA
OSSH sh.a

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
GRUPI I PUNËS

Nr. 2862/2 Prot.,

Tiranë, më 01.10.2026

Lënda: *Ftesë për konsultim dhe paraqitje komentesh mbi "Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike".*

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1, Tiranë

OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST) SH.A.
Autostrada Tiranë–Durrës, km 9, Yrshek, Kashar, Tiranë

OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SH.A. ✓
Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr. 88, H.1, Njësia Administrative nr. 7, Tiranë

FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SH.A.
Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr. 88, H.1, Njësia Administrative nr. 7, Tiranë

SHOQATËS SHQIPTARE TË FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE (AAES)
Rruga "Ibrahim Rugova", nr. 64, Tiranë

SHOQATËS SË MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Rruga "4 Shkurti", nr. 1, kati I, përballë Albtelekomit, Tiranë

AGJENCISË SË MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Rruga "Murat Toptani", 1001, Tiranë

DHOMËS SË TREGTISË DHE INDUSTRISË TIRANË
Rruga e Kavajës, Nd. 2, H. 2, Tiranë

AUTORITETIT TË KONKURRENCËS
Rruga "Sami Frashëri", nr. 4, kati IV, Tiranë

AVOKATIT TË POPULLIT
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë

SHOQATËS "KONSUMATORI NË FOKUS"
Rruga "Mujo Ulqinaku", Pallati Shushica, Ap. 17, Tiranë

FIAA ALBANIA
Rruga "Themistokli Gërmenji", Godina "Pegaso", kati II, ap. 9, Tiranë

Adresa: "Irfan Tomini", Njësia Administrative Nr.7,
Tiranë | web: www.ere.gov.al
Tel: +355 45 620 820, +355 45 620 821
E-mail: erealb@ere.gov.al

SHOQATËS SË PRODHUESVE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME (AREA)
Vila 71, kati III, Rruga e Elbasanit, Tiranë

QENDRËS ALERT
Rruga "Fadil Rada", P. 9/1, Shk. 1, Ap. 4, Tiranë

QENDRËS "KONSUMATORI SHQIPTAR"
Rruga "Kumini", Lagjja 11, Ndërtesa 1319, K.P. 2001, Durrës

Të nderuar,

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ju bën me dije se, me vendimin nr. 274, datë 25.09.2026, ka filluar procedurën për miratimin e "Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike".

Në kuadër të kësaj procedure dhe në zbatim të procesit të konsultimit publik, Grupi i Punës, i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 138, datë 18.08.2026, ju fton të shqyrtoni draftin mbi "Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike" dhe të përcillni pranë ERE-s komentet, vërejtjet dhe sugjerimet tuaja lidhur me përmbajtjen e saj.

Dokumenti për konsultim është publikuar në faqen zyrtare të ERE-s, www.ere.gov.al, në rubrikën "Konsultime", dhe mund të konsultohet nga të gjitha palët e interesuara.

Komentet, vërejtjet dhe sugjerimet mund të paraqiten pranë Entit Rregullator të Energjisë brenda 20 (njëzet) ditëve nga publikimi i njoftimit për konsultim.

Komentet e paraqitura brenda afatit do të administrohen dhe shqyrtohen nga Grupi i Punës në vijim të procedurës së konsultimit dhe shqyrtimit të projektaktit.

KRYETARI

Petrit AHMETI